

VENDIM I KUVENDIT TË AKSIONARËVE TË SHOQËRISË INTERSTOCK SH.P.K.

Recital

Në përputhje me Nenin 104 të Ligjit Nr. 06/L-016 Për Shoqëritë Tregtare, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Interstock Sh.P.K." me numër unik identifikues 810853962, duke vepruar nëpërmjet Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë të përbërë nga aksionarët, z. Edmond Kadriu dhe z. Armend Kadriu, me datë 21.03.2025 merr këtë Vendim për të autorizuar investimin e përbashkët me "Aga" Sh.A., Shoqëri Aksonare e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë e regjistruar me NIPT-i i J62903631L lidhur me hapjen e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në pronësi të përbashkët të këtyre dy Kompanive. Kështu, në përputhje me Statutin e Shoqërisë Interstock Sh.P.K. dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Kuvendi i Aksionarëve të Shoqërisë me datë 15 mars 2025 merr këtë Vendim.

Neni 1

(Objekti dhe ndarja e kuotave)

- 1.1 Autorizohet themelimi i përbashkët i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar me seli në Republikën e Shqipërisë me pronar Interstock Sh.P.K. dhe Aga Sh.A., nën emërtimin "Interstock Albania" Sh.A.
- 1.2 Kapitali i Shoqërisë së re do të jetë vlera prej 1,000,000.00 Lekë (**me fjalë:** një milion lekë), të cilat do të ndahen në dy kuota, nga një për secilin aksionar, të shpërndara si në vijim:
 - Shoqëria "AGNA" Sh.a., do të ketë në pronësi, një kuotë që do të përbëjë 51% (**me fjalë:** pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të shoqërisë së re, vlera monetare në Lekë e të ciles do të jetë 510,000.00 (**me fjalë:** pesëqind e dhjetë mijë lekë);
 - Si dhe:
 - Shoqëria "Interstock" Sh.P.K., do të ketë në pronësi, një kuotë që do të përbëjë 49% (**me fjalë:** katërdhjetë e nëntë përqind) të kapitalit të shoqërisë së re, vlera monetare në Lekë e të cilës do të jetë 490,000.00 (**me fjalë:** katërqind e nëntëdhjetë mijë lekë);

Neni 2

(Aktivitetet dhe Administrimi)

- 2.1 Aktiviteti kryesor afarist i shoqërisë së re do të jetë "*Hapja e njësisë tregtare dhe atyre ndihmëse, për tregëtimin me pakicë të veshjeve të të gjitha llojeve dhe materialeve, të këpucëve, aksesoreve të ndryshëm dhe produkteve të kozmetikës, si dhe çdo produkti tjetër të ngjashëm me përshkrimin e mësipërm. Çdo lloj veprimtarie tjetër tregtare që nuk vjen në kundërshtim me ligjin*".
- 2.2 Selia e shoqërisë së re do të jetë në Autostradën Tiranë – Durrës, Kilometri i Parë, Godina Aga Group, Kati 1, kodi postar 1001, Zona Kadastrale 2679, Nr.Pas. 122/30, Tiranë, Shqipëri.

2.3 Shoqëria e re do të menaxhohet për aq sa përcaktohet në statut nga Administratori, Administrator i Shoqërisë së re për një periudhë prej pesë (5) vitesh do të jetë:

- **Z. Spiro NAÇI**, shtetas Shqiptar, atesia Vasil, amesia Martha, i datelindjes 31/03/1997, lindur ne Greqi e banues ne Gjirokaster, Koca, 02040043, ndertesa Nr: 42, Hyrja Nr: 1, Dropull i siperm, Kakavije 6006, i identifikuar me karten e identitetit me numer 033128830 dhe numer personal J70331020K, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar.

Neni 3

(Përfaqësimi i Shoqërisë pranë Shoqërisë së Re)

3.1 Shoqëria Interstock Sh.P.K., autorizon Drejtorin Menaxhues të Shoqërisë z. Edmond Kadriu që të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe të përmbushë procedurat duke përfaqësuar me autoritet të plotë Shoqërinë „Interstock“ Sh.P.K. lidhur me: nënshkrimin e të gjithë dokumenteve dhe/ose akteve, në lidhje me statutin e shoqërisë “INTER STOCK Albania” sh.p.k., dhe/ose Aktin e Themelimit (edhe nëse këto janë në të njetin akt), derdhjen e kapitalit themeltar, duke përfshirë por pa u kufizuar; për sa më sipër ose/dhe vendime të tjera të kësaj shoqërie që kanë të bëjnë kufizimet, kompetencat, përcaktimin e shpërblimeve dhe bonuseve për Administratorët e shoqërisë së re, apo të çdo lloj akti apo marrevëshje tjetër të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin e pikave të shitjes (njesive) për shoqërinë e re, me hapjen e llogarive bankare, aktivizimin e shërbimeve e-banking dhe përcaktimin e të drejtave dhe kufizimeve për përdorimin e tyre nga personat e autorizuar në statutin, si dhe të tjera vendime të mëvonëshme që kanë të bëjnë me nisjen dhe vënien e aktivitetit në cikël normal operimi të shoqërisë së re si më sipër.

3.2 Ky Vendim hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit nga aksionari i vetëm i Shoqërisë.

Në emër të Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë “Interstock” Sh.P.K. aksionarët që përfaqësojnë 100% të kapitalit aksionar të Shoqërisë:

15 mars 2025, Prishtinë:


Edmond Kadriu, aksionar




Armend Kadriu, aksionar